ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

PËRZGJEDHJA E STAFIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS:
Ç'duhet bërë ndryshe?



PËRZGJEDHJA E STAFIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS:
Ç’duhet bërë ndryshe?

Botues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Simon Shiroka, H. 11, Nr. 8
10000, Prishtinë, Kosovë

Ky raport u përpilua nga:
Fitore Metbala
Fatjeta Ibishi
Rina Kika

Redaktor gjuhësor:
Gazmend Bërlajolli

Dizajni dhe faqosja:
envinion

Shkurt 2020
Prishtinë

PËRMBAJTJA

I. Hyrje 4

II. Të dhënat e përgjithshme 5

1. Parregullsitë në buletinet – raportet vlerësuese 7

2. Parregullsitë në përbërjen e komisioneve vlerësuese 12

3. Parregullsitë në lidhje me shqyrtimin e ankesave dhe procesin vendimmarrës 13

III. Përfundime 19

IV. Rekomandime 21

Shtojcë: Procesi i përzgjedhjes së personelit akademik 23

Hyrje

Përzgjedhja dhe avancimi i personelit akademik në Universitetin e Prishtinës janë ndër proceset më me ndikim në cilësinë e mësimdhënies. Duke qenë zbatimi i rregullave në fuqi qenësor për mbarëvajtjen e procesit mësimor, me t'u hapur konkursi për emërime, riemërime dhe avancime në vitin 2018, ORCA publikoi një dokument me udhëzime të përgjithshme për procedurën e ankesave në universitet, në mënyrë që t'ua lehtësojë kandidatëve paraqitjen e tyre. Po ashtu, monitoroi së afërmi avancimet akademike gjatë vitit 2018, duke ofruar mbështetje juridike për palët ankuese.

Ky raport sjell gjetjet e parregullsive ligjore gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të avancimit të personelit akademik në vitin 2018, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e tij. Gjetjet për raportin u grumbulluan gjatë kohës së ofrimit të mbështetjes ligjore falas 26 kandidatëve me procedimin e ankesave për adresimin e parregullsive. Duhet nënvizuar se jo të gjithë kandidatët na e kanë ofruar dokumentacionin e plotë të ankesave dhe se disa, të dëshpëruar nga i gjithë procesi i konkurrimit, nuk na njoftuan mbi epilogun e ankesave të tyre.

Raportimet e kandidatëve rreth parregullsive me paraqitjen e ndryshuar, të mangët ose mosparaqitjen e të dhënave të tyre nëpër raportet vlerësuese, ky publikim i supozon të sakta duke u bazuar në të dhënat nga dokumentet e paraqitura prej tyre në konkurse.

Raporti nuk jep vlerësime mbi të arriturat akademike në punimet shkencore të kandidatëve ose mbi pretendimet rreth vlerësimit të padrejtë të arritjeve të tyre nga ana e universitetit. Ky publikim radhit vetëm parregullsitë procedurale me ndikim në vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve.

Raportimet për parregullsi të **26 kandidatëve** janë analizuar sipas rregullave të zbatueshme për procesin e avancimeve akademike të vitit 2018, duke u mbështetur, ndër të tjera, në burimet e mëposhtme:

- Buletinet e Universitetit të Prishtinës me raportet vlerësuese për vitin 2018;
- Raportet e Komisioneve Vlerësuese;
- Ankesat e kandidatëve;
- Raportet e Komisioneve për Ankesa;
- Disa vendime të Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtresa;
- Intervistimet e së paku 13 kandidatëve dhe mbajtjen e kontaktit me ta gjatë procesit ankimor;
- Letrat drejtuar Rektorit dhe Senatorëve për parregullsitë e hasura gjatë procesit të emërimit dhe avancimit, si dhe pakënaqësitë lidhur me procesin e vlerësimit në komisionet vlerësuese;
- Njoftimet dhe kërkesat drejtuar dekanateve përkatëse (kërkesa për sqarime, njoftime për parregullsi, etj.);
- Ankesat dorëzuar Inspektoratit të Punës nga kandidatët;
- Njoftimet e kandidatëve dërguar Rektorit për dyshimet mbi konflikt interesi në komisionet vlerësuese;
- Njoftimet për Agjencinë Kundër Korrupsionit për dyshime mbi konflikt interesi;
- Denoncimet e dorëzuara në Këshillin e Etikës së Universitetit të Prishtinës «Hasan Prishtina»;
- Përgjigjet zyrtare ndaj 10 kërkesave për qasje në dokumentet publike me pyetje për konkursin e vitit 2018, nga: Rektorati i Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore, Fakulteti i Ndërtimtarisë, Fakulteti i Arkitekturës, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, si dhe Fakulteti i Filologjisë;
- Letrën e hapur të Dekanit të Fakultetit Juridik për sqarim lidhur me konkursin për staf akademik, të publikuar në «Koha Ditore»;
- Opinionin e Insitucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me ankesën e palës ndaj konkursit për personel akademik të Universitetit të Prishtinës «Hasan Prishtina», etj.

Të dhënat e përgjithshme

Gjatë periudhës qershor-tetor 2018, mbi 50 kandidatë kanë raportuar në ORCA parregullsitë e hasura në konkursin për emërim, riemërim dhe avancim akademik në Universitetin e Prishtinës «Hasan Prishtina». Ky raport paraqet të dhënat nga raportimet e **26** prej tyre. Nga këta, kemi ofruar mbështetje ligjore për 7 kandidatë për procedimin e ankesave, ndërkaq 19 të tjerë kanë kërkuar vetëm informata sipërfaqësore mbi procesin ankimor dhe na kanë vënë në dispozicion shumicën e dokumentacionit të tyre, bashkë me vendimet e universitetit (kur të tilla ka pasur).

Kanë raportuar për parregullsi: 13 kandidatë konkurrentë në Fakultetin e Mjekësisë, 4 në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, 2 në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës, 2 në Fakultetin Juridik, 1 në Fakultetin Ekonomik, 2 në Fakultetin e Edukimit, 1 në Fakultetin Filologjik dhe 1 në Fakultetin e Bujqësisë dhe të Veterinarisë.

Parregullsitë kyçe, të evidentuara në këtë raport, janë përmbledhur në tri grupe, sipas fazës së zhvillimit të procesit dhe natyrës së tyre:

1. Parregullsitë në buletinet - raportet vlerësuese;
2. Parregullsitë në përbërjet e komisioneve vlerësuese;
3. Parregullsitë në shqyrtimin e ankesave dhe në procesin e vendimmarrjes.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PARREGULLSITË	NUMRI I PARREGULLSIVE
1. Parregullsitë në buletinet - raportet vlerësuese	
1.1 Mungesa e arsyetimeve në raportet vlerësuese	⊗ 10
1.2 Mosllogaritja ose keqllogaritja e përvojës së punës, pa dhënë arsyetim	⊗ 9
1.3 Paraqitja e ndryshuar ose jo e plotë e të dhënave, pa dhënë arsyetim	⊗ 10
1.4 Raportime për radhitjen e punimeve të papublikuara dhe ndryshimi i radhitjes së punimeve pa dhënë arsyetim	⊗ 2
1.5 Raportime për mungesën e nënshkrimeve në raportet vlerësuese	⊗ 1
1.6 Anulimi i konkursit nga Fakulteti Juridik	⊗ 1
2. Parregullsitë në përbërjet e komisioneve vlerësuese	
2.1 Konflikt interesi mes anëtarëve të komisionit dhe kandidatëve	⊗ 5
2.2 Pjesëmarrja në komision vlerësues e anëtarëve që nuk janë të fushës përkatëse	⊗ 3
3. Parregullsitë në lidhje me shqyrtimin e ankesave dhe procesin vendimmarrës	
3.1 Mosrespektimi i formatit të vendimeve, të përcaktuar me ligj	
3.2 Komunikimi jozyrtar dhe mosdhënia e përgjigjes me shkrim palëve që kanë parashtruar ankesa	

1 Parregullsitë në buletinet - raportet vlerësuese

Buletini është dokument publik i Universitetit të Prishtinës që përbëhet nga raportet vlerësuese për kandidatët në procesin e përzgjedhjes së personelit akademik.[1] Komisionet vlerësuese rekomandojnë përzgjedhjen e kandidatëve që i plotësojnë kriteret e nevojshme dhe që sipas vlerësimit të përgjithshëm të aktivitetit të tyre shkencor/artistik, profesional e akademik, janë më të mirë në krahasim me kandidatët e tjerë.[2]

Janë gjashtë lloj parregullsish kryesore të evidentuara në lidhje me buletinet e publikuara gjatë procesit konkurrues për përzgjedhje të stafit akademik më 2018:

- Mungesa e arsyetimeve në raportet vlerësuese;
- Mosllogaritja ose keqllogaritja e përvojës së punës, pa dhënë arsyetim;
- Paraqitja e ndryshuar ose jo e plotë e të dhënave, pa dhënë arsyetim;
- Radhitja e punimeve të papublikuara dhe ndryshimi i radhitjes së punimeve në raportet vlerësuese, pa dhënë arsyetim;
- Mungesa e nënshkrimeve në raportet vlerësuese; dhe
- Anulimi i konkursit nga Fakulteti Juridik.

1.1. Mungesa e arsyetimeve në raportet vlerësuese

Komisioni vlerësues duhet ta arsyetojë rekomandimin që jep për përzgjedhjen e kandidatit të cilin e vlerëson si më të mirin.[3] Arsyetimi në aktet administrave, siç është vetë raporti vlerësues, duhet të përmbajë:

a) paraqitje të shkurtër ndaj kërkesës së palës,
b) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi,
c) shkaqet që kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të dokumenteve/dëshmive,
ç) bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, si dhe
d) shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjë nga pretendimet e palëve.[4]

Për më shumë, një arsyetim i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës, ose i pakuptueshëm, sipas ligjit konsiderohet i barabartë me mungesën e tij.[5] Rrjedhimisht, akti administrativ konsiderohet i paligjshëm nëse nuk përmban arsyetim sipas kushteve të mësipërme.[6]

Janë raportuar së paku **12 raste** në të cilat arsyetimi në raportet vlerësuese ka qenë i paqartë ose ka munguar fare. Prandaj kandidatët kanë kontestuar ligjshmërinë e këtyre raporteve vlerësuese duke paraqitur ankesa. Prej 12 rasteve, pas shqyrtimit të raporteve vlerësuese, janë verifikuar **10** me pretendime të bazuara në këtë aspekt.

1 Neni 12, paragrafët 3 dhe 4, Rregullorja nr. 465 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës «Hasan Prishtina» (në vazhdim: «**Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik**»)
2 Neni 11, paragrafi 19 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
3 Neni 11, paragrafi 19 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
4 Neni 48, paragrafi 1 Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
5 Neni 48, paragrafi 2 Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
6 Neni 52, paragrafi 1, nënparagrafi 4, Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

1.2. Mosllogaritja ose keqllogaritja e përvojës së punës, pa dhënë arsyetim

Paraqitja në buletine e të dhënave të sakta të përvojës së punës dhe e përgatitjes së kandidatëve është përgjegjësi e komisioneve vlerësuese.[7] Anëtarët e komisioneve vlerësuese madje mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore e etike për vërtetësinë e të dhënave të raporteve vlerësuese dhe për rekomandimet sipas Kodit të Etikës dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi.[8] Megjithatë, njëra ndër ankesat më të shpeshta ndaj procesit përzgjedhës është paraqitja e të dhënave të mangëta të kandidatëve në buletine pa ofruar arsyetim.

Në dokumentacionin për konkurrim, kandidatët deklarojnë vitet dhe institucionet e përvojës në mësimdhënie. Janë raportuar **11 raste** në të cilat kandidatët kanë pretenduar se të dhënat e publikuara në buletine mbi përvojën e punës së tyre kanë qenë në shpërputhje me ato të dokumentacionit të dorëzuar për konkurrim. Sipas kandidatëve, komisionet vlerësuese pas shqyrtimit të dokumenteve, pa u dhënë arsyetim kandidatëve, kanë vendosur t'ua njohin më pak vite të përvojës së punës ose të mos ua njohin fare. Në 11 raportet e verifikuara të komisioneve vlerësuese, rezulton se në **9 prej tyre** nuk është ofruar asnjë arsyetim në lidhje me mosllogaritjen e përvojës së punës ose të përvojës së plotë të punës të kandidatëve.

1.3. Paraqitja e ndryshuar ose e mangët e të dhënave pa dhënë arsyetim

Ndër ankesat më të raportuara prej kandidatëve ishte paraqitja e ndryshuar ose jo e plotë e të dhënave të tyre në raportet vlerësuese, pa kurrfarë arsyetimi shoqërues. Kandidatët i kanë paraqitur të dhënat në formularët e konkurrimit duke bashkëngjitur dokumentacionin përkatës. Sidoqoftë, sipas **21 raportimeve** të kandidatëve, nga të cilat 10 janë verifikuar, këto të dhëna janë ndryshuar ose janë paraqitur të mangëta nga komisionet vlerësuese në buletinet e publikuara, pa kurrfarë arsyetimi. Pretendimet e palëve në lidhje me këto parregullsi janë grupuar si vijon:

Paraqitja e ndryshuar e të dhënave për punime shkencore dhe publikime të tjera	**10 raste;**

Formulari tabelar i konkurrimit evidenton aktivitetin hulumtues, shkencor dhe profesional të kandidatit.[9] Komisionet vlerësuese i shënojnë të dhënat mbi publikimet në tabelën e punimeve të publikuara në revista të indeksuara ndërkombëtare, si dhe në revista akademike ose shkencore ndërkombëtare a vendore. Gjithsej 11 kandidatë kanë parashtruar ankesë në universitet nën pretendimin se një ose më shumë punime të tyre mungojnë në tabelat e paraqitura nga komisionet vlerësuese. Në **10 raste**, raportet e verifikuara të komisioneve vlerësuese nuk kanë ofruar ndonjë arsyetim për paraqitjen e mangët të të dhënave mbi punimet shkencore ose publikimet e tjera.

7 Neni 11, paragrafi 15 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
8 Neni 11, paragrafi 25 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik dhe neni 4, paragrafi 1 Rregullorja për korrigjimet teknike të Rregulores nr.465, e datës 02 mars 2018 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës «Hasan Prishtina».
9 Shtojca Nr.II, Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.

Mosparaqitja e informatës për punime të publikuara në revista shkencore me impakt faktor	**3 raste;**

Termi «impakt faktor» përdoret për të përshkruar ndikimin e autorit dhe të revistës shkencore.[10] «Impakt faktori është matës i nivelit të revistave shkencore që siguron indeksimin e rangimit shkencor dhe prestigjin e revistës shkencore» (sa më i lartë aq më i mirë dhe aq më i vështirë botimi i dorëshkrimit në atë revistë)[11]. Rëndësia e publikimit në revista me impakt faktor është e pamohueshme. Impakt faktori njihet nga Statuti i Universitetit të Prishtinës e madje Ministria e Arsimit ka nxjerrë Udhëzim Administrativ për mbulimin e shpenzimeve të autorëve që publikojnë në revista me impakt faktor.[12]

Pavarësisht kësaj, janë raportuar 3 **raste** kur në raportet vlerësuese nuk janë paraqitur informatat se kandidatët kanë publikuar punime shkencore në revistë me impakt faktor.

Mosparaqitja e titujve ose mosparaqitja e diplomave të nivelit master dhe të doktoratës	**4 raste;**

Katër kandidatë kanë raportuar se në raportet vlerësuese nuk u janë paraqitur të dhëna të plota apo nuk u janë paraqitur fare të dhënat mbi nivelin e shkollimit (PhD, kandidat për PhD, ose Master). Pas verifikimit të raporteve vlerësuese, është vërtetuar se për të **4 rastet**, nuk janë dhënë arsyetime për paraqitjen jo të plotë apo mosparaqitjen e këtyre të dhënave.

Mosparaqitja/paraqitja e mangët e të dhënave rreth monografisë	**3 raste;**

Botimi i monografisë është kusht për fitimin e titullit Profesor Asistent në Universitetin e Prishtinës.[13] Tre kandidatë kanë raportuar se nuk u është paraqitur fare monografia e publikuar ose u janë ndryshuar të dhënat për monografinë në raportin vlerësues.

Paraqitje e ndryshuar e notës mesatare	**1 rast;**

Për pozitën e asistentit në Universitetin e Prishtinës kërkohet që kandidati ta ketë notën mesatare në studimet Bachelor si dhe Master jo më pak se 8.[14] Komisioni vlerësues në një rast e ka arsyetuar refuzimin e kandidatit duke u thirrur në mospërmbushjen e këtij kriteri. Megjithatë, po në të njëjtin raport komisioni vlerësues konstaton se kandidati në fjalë ka notë mesatare mbi 8 në të dyja nivelet.

10 The evolution of the Science Citation Index, Eugene Garfield, 2007, gjendet në: http://garfield.library.upenn.edu/papers/barcelona2007a.pdf,
11 Increasing importance of research metrics: Journal Impact Factor and h-index, Victor Grech dhe Diaa E. E. Rizk, 2018, gjendet në: https://link.springer.com/article/10.1007/s00192-018-3604-8
12 Neni 183, paragrafi 3 Statuti i Universitetit të Prishtinës; Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr.1/2017 për Publikimet dhe Botimet Shkencore në Revistat me Faktorë Ndikimi.
13 Neni 177, paragrafi 1, nënparagrafi 2 Statuti i Universitetit të Prishtinës.
14 Neni 7, paragrafi 1, nënparagrafi 4 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.

1.4. Radhitja e punimeve të papublikuara dhe ndryshimi i radhitjes së punimeve në raportet vlerësuese, pa dhënë arsyetim

Ndër kriteret kyçe për përzgjedhjen dhe avancimin akademik të kandidatëve, bazuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës, është numri i caktuar i punimeve të publikuara nëpër revista shkencore në momentin e konkurrimit.[15] Komisioni vlerësues është i obliguar që në raportin vlerësues për kandidatin përkatës të listojë: autorët e punimit, titullin e punimit, revistën, vëllimin, numrin, faqet, vitin e publikimit si dhe vegëzën përmes së cilës dëshmohet indeksimi i punimit, përkatësisht i revistës, në bazën e caktuar akademike.[16]

Janë raportuar të paktën **2 raste** në të cilat komisionet vlerësuese kanë llogaritur punime ende të papublikuara të kandidatëve, duke dalë në anën tjetër me vlerësim negativ për kandidatin me punim tashmë të publikuar.

Me rregullat e zbatueshme nuk mjafton vetëm konfirmimi nga revista shkencore për publikimin e punimit në të ardhmen; ai duhet të jetë i publikuar në momentin e konkurrimit.[17] Praktika të tilla haptas bien ndesh me rregullat që e qeverisin procesin e konkurrimit dhe të shqyrtimit të kualifikimeve të kandidatëve në proces.

1.5. Mungesa e nënshkrimeve në raportet vlerësuese

Raporti vlerësues nënshkruhet nga të tre anëtarët e komisionit vlerësues dhe dorëzohet në këshillin e fakultetit përkatës nga kryetari i komisionit.[18] Është raportuar **një rast** në të cilin jo të gjithë anëtarët e komisionit vlerësues kanë nënshkruar raportin vlerësues.

1.6. Anulimi i konkursit nga Fakulteti Juridik

Komisionet vlerësuese janë të obliguara të dorëzojnë raportin e vlerësimit 15 ditë pas mbylljes së konkursit.[19] Në rastet kur komisionet dështojnë ta bëjnë këtë, Këshilli i Fakultetit ka të drejtë të formojë një komision të ri për vlerësimin e kandidatëve.[20]

Përveç raportimeve të përgjithshme për vonesa në publikimin e buletineve, ka pasur një raportim nga Fakulteti Juridik, ku fare nuk është publikuar buletini për pozitën e hapur përmes konkursit publik.[21] Në lidhje me konkursin në fjalë, Dekani i Fakultetit Juridik me datë 29 maj 2018 i është drejtuar Rektorit të Universitetit me letër të hapur, të publikuar në gazetën e përditshme «Koha Ditore»,[22] duke e njoftuar se shumë nga kandidatët kanë pasur lidhje të ndryshme familjare, shoqërore e kolegiale në Fakultet dhe prandaj kanë pasuar dorëheqje nga anëtarët e komisioneve vlerësuese, për shkak të mundësisë së ndikimit dhe të konfliktit të interesit.[23] Sipas Dekanit, për shkak të këtyre rrethanave është themeluar një komision nga pjesëtarë të stafit të pensionuar, mirëpo sërish një anëtar i komisionit është tërhequr dhe komisioni ka rezultuar jofunksional.[24]

15 Neni 175, paragrafi 1.2.1, neni 176, paragrafi 1.2, neni 177, paragrafi 1.2, Statuti i Universitetit të Prishtinës.
16 Shtojca II, Tabela II, Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
17 Po aty.
18 Neni 11, paragrafi 22, Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
19 Neni 11, paragrafi 15, Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
20 Neni 11, paragrafi 16, Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
21 Konkursi me Nr. Protokolli 1/173 i shpallur më datë 27.04.2018 nga Universiteti i Prishtinës «Hasan Prishtina».
22 Njoftim dhe sqarim lidhur me konkursin e fundit për ŝtaf akademik, nga Prof. Asoc.Dr. Haxhi Gashi, Dekan, për Prof. Dr. Marjan Dema, Rektor, e datës 29.05.2018, e publikuar në Koha Ditore.
23 Po aty.
24 Po aty.

Në mungesë të anëtarëve në marrëdhënie të rregullt pune, anëtarë të komisonit vlerësues mund të emërohen, përveç stafit të pensionuar, edhe profesorë nga universitete të tjera nga vendi dhe jashtë, me kusht që njëri nga tre anëtarët të jetë profesor në Universitetin e Prishtinës.[25] Prandaj, i jemi drejtuar Dekanit të Fakultetit Juridik me kërkesë për qasje në dokumente publike për të kuptuar se a është shfrytëzuar mundësia për emërimin e profesorëve nga universitete të tjera nga vendi dhe jashtë në komisionin vlerësues për realizimin e konkursit për përzgjedhjen e stafit akademik.

Dekani i Fakultetit Juridik, Haxhi Gashi, është përgjigjur:

> «Kur kemi pasur dorëheqje të anëtarëve të Komisioneve për shkak të konfliktit të interesit dhe shkaqe tjera objektive, kemi ndërruar anëtarët e Komisioneve sipas Rregullores dhe kemi formuar Komisione të reja. Këtë veprim e kemi bërë tri herë radhazi në mbledhje të Këshillit. Kemi provuar edhe me anëtarë të Fakultetit Ekonomik. Por pasi që Rregullorja nuk ka paraparë mundësi tjera, në rast të ndërrimit të anëtarëve në mënyrë të vazhdueshme (sepse një anëtar gjithë duhet të jetë nga Fakulteti) dhe pas tejkalimit të të gjitha afateve, kur është diskutuar për formim e komisionit herën e tretë, me vendim të Këshillit çështja është referuar në Senat, për të anuluar dhe përsëritur konkursin me qëllim që të ruhet objektiviteti i vendimmarrjes-zgjedhjes së stafit.»[26]

Rregullorja i parasheh tri mundësi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Vlerësues në rast se dështon formimi i komisionit vlerësues brenda fakultetit: **a)** emërimi i profesorëve nga departamente të tjera (në këtë rast kryetari i komisionit duhet të jetë nga radha e profesorëve të departamentit për të cilin vlerësohen aplikacionet), **b)** emërimi i profesorëve të pensionuar që kanë thirrjet akademike nga lëmia përkatëse, **c)** emërimi i profesorëve nga universitete të tjera vendore ose të jashtme.[27] Fakulteti Juridik në konkursin Nr. 1/173 të datës 27 prill 2018 nuk e ka shfrytëzuar mundësinë që e ofron rregullorja për emërimin e profesorëve nga universitete të tjera vendore ose të jashtme.

Sa i përket argumentit se kanë kaluar «të gjitha afatet», duhet theksuar se afati për realizimin e konkursit për zgjedhjen e stafit akademik mund të zgjatet deri në **205 ditë**, përndryshe pozita rishpallet në konkursin e radhës.[28] Në rast të ndërrimit të anëtarëve të komisionit vlerësues, afati për nxjerrjen e raporteve vlerësuese është **32 ditë** pas shpalljes së konkursit.[29] Fakulteti Juridik ka kërkuar anulimin e konkursit në fjalë saktësisht **32 ditë** pas shpalljes së tij. Me të kaluar ky afat, gjithsej me afatet e tjera konkursi do të zgjaste **192 ditë**.[30] Pra, ka kaluar afati për nxjerrjen e raporteve vlerësuese, por jo edhe afati i përgjithshëm i përfundimit të konkursit që e shkakton anulimin e konkursit dhe rishpalljen e pozitës në konkursin e radhës (**205 ditë**). Rrjedhimisht, anulimi i konkursit **32 ditë** pas shpalljes, me arsyetimin se kanë kaluar «të gjitha afatet» nuk është argument i qëndrueshëm juridik, pasi që nuk ka kaluar afati që e shkakton anulimin e konkursit dhe rishpalljen e pozitës në konkursin e radhës.

Në këtë rast, Fakulteti Juridik nuk ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ta parandaluar dështimin e procesit konkurrues për pozitën e hapur. Mund të konsiderohet se kërkesa për anulimin e konkursit është bërë pa e përfillur parimin e efikasitetit të procedurës administrative, sipas të cilit organi publik duhet ta zhvillojë procedurën sa më shpejt dhe me sa më pak shpenzime për të dhe për palën, duke mos cenuar ç'është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative.[31]

25 Neni 11, paragrafi 9 dhe 10 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
26 Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit Juridik, Haxhi Gashi, 27 janar 2020.
27 Neni 11, paragrafi 9, 10 dhe 11 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
28 Neni 14, paragrafi 4 dhe 5 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
29 Neni 11, paragrafi 12 dhe 17 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
30 Po aty.
31 Neni 10 paragrafi 2, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2 Parregullsitë në përbërjen e komisioneve vlerësuese

ORCA ka pranuar raportime për parregullsi në përbërjen e komisioneve vlerësuese. Kryesisht, raportimet kanë qenë për:

- Konflikt interesi mes anëtarëve të komisioneve vlerësuese dhe kandidatëve dhe
- Pjesëmarrje në komision vlerësues të anëtarëve që nuk janë të fushës së ngushtë përkatëse.

2.1 Konflikt interesi mes anëtarëve të komisionit dhe kandidatëve

Anëtarët e komisioneve nuk duhet të marrin pjesë në komisionet për të cilat ftohen nga universiteti, në qoftë se evidentojnë konflikt interesi.[32] Palët me pretendime për konflikt interesi mes anëtarëve të komisionit dhe kandidatëve të caktuar i kanë adresuar këto çështje në ankesat e paraqitura Komisioneve të Ankesave si dhe këshillave të fakulteteve përkatëse.

Shumica e pretendimeve për konflikt interesi kanë qenë të natyrës së raporteve të afërta profesionale, si: kryetari ose anëtari i komisionit vlerësues ka qenë autor korrespodent me kandidatin të cilin e ka vlerësuar, ose kandidati ka qenë asistent në ligjëratat e njërit nga anëtarët e komisionit vlerësues. Këto nuk përcaktohen shprehimisht në Udhëzuesin e Këshillit të Etikës si marrëdhënie që paraqesin konflikt interesi. Sidoqoftë, lista e raporteve që paraqesin konflikt interesi nuk është shteruese dhe sipas Këshillit të Etikës së UP-së, «është përgjegjësia e anëtarëve të stafit për të marrë çfarëdo mase të nevojshme në bazë të logjikës dhe arsyeshmërisë për t'iu shmangur nepotizmit në rast të lidhjeve të tjera që nuk përfshihen shprehimisht në listë».[33] Nepotizëm sipas udhëzuesit të Këshillit të Etikës konsiderohet edhe marrëdhënia e miqve të ngushtë.[34] Prandaj, do të mund të cilësohej si konflikt i interesit edhe raporti në të cilin kandidati ka qenë asistent i njërit nga anëtarët e komisioneve vlerësuese, ose rasti kur kandidati ka qenë autor korrespodent me anëtarin e komisionit.

Gjithsej **5 kandidatë** kanë parashtruar ankesa me pretendime për konflikt interesi, të cilat asnjëri vendim për ankesat nuk i adreson.

32 Neni 187, paragrafi 2 Statuti i Universitetit të Prishtinës.
33 Këshilli i Etikës, Universiteti i Prishtinës «Hasan Prishtina», Udhëzues për standardet dhe parimet etike të Universitetit të Prishtinës në lidhje me shmangien e nepotizmit dhe parandalimin e konfliktit të interesit në procedurat e zgjedhjes së personelit akademik për pozita të reja, sipas institucionit të konkursit publik, Nr. 1/210, 2 maj 2018, faqe 4, paragrafi 9.
34 Po aty.

2.2 Pjesëmarrja në komision vlerësues e anëtarëve që nuk janë të fushës përkatëse

Për çdo pozitë të shpallur në konkursin për përzgjedhje të stafit akademik caktohet një komision vlerësues prej tre (3) anëtarëve nga fakulteti në të cilin do të angazhohet kandidati i përzgjedhur.[35] Komisionet vlerësuese duhet të përbëhen nga radhët e profesorëve në nivel departamenti ose programi përkatës, ndërsa të paktën dy anëtarë të komisionit vlerësues duhet të jenë nga fusha e ngushtë e lëndëve për të cilat është shpallur konkursi.[36] Në vetëm dy raste përjashtimisht mund të emërohen në komision profesorë nga departamente të tjera: a) kur nuk ka numër të mjaftueshëm të profesorëve të fushës së ngushtë dhe b) kur anëtarët e komisionit vlerësues nuk kanë thirrje më të lartë ose të njëjtë akademike me pozitën për të cilën ka aplikuar kandidati.[37] Sidoqoftë, edhe në këto dy raste, kryetari i komisionit duhet patjetër të jetë nga radha e departamentit për të cilin vlerësohen aplikacionet për përzgjedhje akademike.[38]

Sipas raportimeve të kandidatëve, ndër parregullsitë e shpeshta ishte emërimi për kryetarë të komisioneve vlerësuese i pjesëtarëve të departamenteve a degëve që nuk përkojnë me pozitën e aplikuar. Janë evidentuar **tri raste** në të cilat kandidatët kanë ngritur pretendime për parregullsi në përbërjen e komisioneve. Vendimi për këto ankesa (raporti i komisioneve ankimore dorëzuar kandidatëve) nuk e ka adresuar asnjërin pretendim të palëve për parregullsi në komisionin vlerësues.

35 Neni 11, paragrafi 2, Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
36 Neni 11, paragrafi 4, 6 dhe 7, Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
37 Neni 11, paragrafi 9, Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
38 Po aty.

3 Parregullsitë në lidhje me shqyrtimin e ankesave dhe procesin vendimmarrës

E drejta për ankesë u siguron kandidatëve mundësinë e sfidimit të vlerësimit të tyre në një organ të shkallës së dytë në rast pakënaqësie me raportin vlerësues të komisionit vlerësues të shkallës së parë.[39] Përveç ankesave brenda Universitetit të Prishtinës (si në komisionet për ankesa, këshillet e fakulteteve, Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtresa, Këshillin e Etikës të UP-së, Këshillin Drejtues të UP-së), kandidatët e pakënaqur me vlerësimin kanë kërkuar adresimin e parregullsive edhe jashtë Universitetit të Prishtinës. Një numër ankesash janë drejtuar edhe në Inspektoratin e Arsimit, Inspektoratin e Punës, Institucionin e Avokatit të Popullit, Polici, Gjykatë, Prokurori, Agjencinë Kundër Korrupsionit, etj.

a) Ankesat brenda Universitetit të Prishtinës

Gjithsej **21 kandidatë** që na kanë kontaktuar kanë parashtruar **25 ankesa**[40] kundrejt raporteve vlerësuese të shkallës së parë në komisionet e ankesave të fakulteteve përkatëse. Njëri nga ta ka marrë përgjigje pozitive, dy kanë raportuar se nuk kanë marrë përgjigje dhe të gjithë të tjerët kanë marrë përgjigje negative. Ndërkaq, tre kandidatë kanë refuzuar të na njoftojnë për epilogun e procesit të tyre ankimues, duke u shprehur të zhgënjyer me procesin e konkurrimit në universitet.

Për plotësimin e të dhënave të këtij raporti, kemi parashtruar 10 kërkesa për qasje në dokumente publike për Universitetin e Prishtinës dhe Fakultetet në të cilat kanë kandiduar palët raportuese. Kërkesat ia kemi dërguar: Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetit të Ndërtimtarisë, Fakultetit të Arkitekturës, Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Filologjik, si dhe Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë. Të gjithë i janë përgjigjur kërkesës sonë për qasje në dokumente publike dhe na kanë dhënë informata për pothuajse të gjitha pyetjet e parashtruara.

Fakultetet në përgjigjet e tyre kanë treguar se nuk ka pasur **asnjë rast** kur anëtarët e komisioneve vlerësuese ose të komisioneve ankimore kanë dhënë përgjegjësi disiplinore, etike ose ligjore lidhur me vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportet vlerësuese ose të rekomandimeve që i kanë bërë.[41]

Sipas Sekretarit të Universitetit të Prishtinës, në konkursin e vitit 2018 janë raportuar gjithsej **8**

39 Neni 12, paragrafi 6 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.

40 Numri i kandidatëve që kanë ushtruar ankesë është 21, ndërkaq numri i ankesave është 25 për shkak se 4 kandidatë nga Fakulteti i Mjekësisë kanë paraqitur nga dy ankesa meqë kanë aplikuar në dy pozita secili.

41 Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekanja e Fakultetit të Mjekësisë, Suzana Manxhuka, 30 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Sekretari i Fakultetit të Mjekësisë, Visar Muçaj, 31 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Sekretari i Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore, Jeton Hyseni, 23 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit të Ndërtimtarisë, Abdullah Zejnullahu, 22 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit të Arkitekturës, Fevzi Berisha, 22 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit Juridik, Haxhi Gashi, 27 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit Ekonomik, But Dedaj, 24 janar 2020; Përgjigjet në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Sekretari i Fakultetit të Edukimit, Milaim Mazreku, 29 janar 2020 dhe 30 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekanja e Fakultetit Filologjik, Lindita Sejdiu-Rugova, 24 janar 2020; dhe Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Skender Kaçiu, 31 janar 2020.

raste ndaj anëtarëve të komisioneve vlerësuese para Këshillit të Etikës.[42] Të gjitha «kanë përfunduar me vendime të Këshillit të Etikës duke konstatuar se nuk ka rast sipas Kodit të Etikës».[43] Sekretari ka spjeguar se ankesat janë cilësuar si ankesa për çështje "akademike", prandaj Këshilli i Etikës e ka konsideruar veten si jo-kompetent për shqyrtimin e tyre dhe i ka kthyer lëndët për shqyrtim në këshillet e fakulteteve.[44]

Pas shqyrtimit të ankesave në komisionet e ankesave dhe votimit në Këshillet e Fakulteteve,[45] vendimin për përzgjedhjen e kandidatëve e merr Senati.[46] Kandidatët e pakënaqur me vendimet e Senatit mund të parashtrojnë ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtresa.[47]

Sipas Sekretarit të Universitetit të Prishtinës, ndaj vendimeve të Senatit për përzgjedhjen e stafit akademik janë paraqitur gjithsej **64 ankesa**, ndërkaq Komisioni i Senatit për Ankesa dhe Parashtresa ka rekomanduar rishqyrtimin e **16 prej tyre** në Senat.[48] Sekretari i Universitetit na ka njoftuar se të gjitha ankesat, pas shqyrtimit, janë refuzuar si të pabazuara nga Senati.[49]

Në ORCA janë paraqitur **16 kandidatë** që kanë raportuar për ankesat e tyre para Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtresa. Prej tyre, 11 kanë marrë përgjigje negative, 3 kanë marrë përgjigje pozitive për rishqyrtim të lëndëve në Senat, 1 nuk ka ofruar informata mbi vendimin për ankesën e vet, ndërkaq 1 ka deklaruar se nuk e di epilogun në lidhje me ankesën e vet.

b) Ankesat jashtë Universitetit të Prishtinës

Në gjithsej 13 raste, kandidatët kanë vijuar të sfidojnë vendimet e Senatit në Inspektoratin e Punës. Nga to, 9 kanë rezultuar me përgjigje pozitive, 3 me negative, dhe për 1 nuk kemi informata mbi përfundimin e procesit.

Me ankesa në Inspektoratin e Arsimit janë drejtuar gjithsej 4 kandidatë. Dy nga ta kanë marrë përgjigje se, për shkak të ndryshimit të legjislacionit, rastet duhet t'ia drejtojnë Inspektoratit të Punës. Një ankesë është aprovuar në favor të palës me vendimin që fakulteti përkatës ta shkarkojë komisionin vlerësues ndaj të cilit është ngritur ankesa dhe të formojë një të ri.

Nga 4 rastet e ngritura në Gjykatë, njëri nga kandidatët e ka tërhequr padinë, për arsye se e ka konsideruar humbje kohe dhe resursesh, duke qenë i zhgënjyer me procesin e zhvilluar në Universitetin e Prishtinës.

Lidhur me çështjen e konfliktit të interesit, 1 kandidat i është drejtuar Agjencisë Kundër Korrupsionit. Në opinionin e nxjerrë lidhur me çështjen, Agjencia është përgjigjur se nuk ka gjetur konflikt të interesit.

42 Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës, Esat Kelmendi, 17 janar 2020.
43 Po aty.
44 Kërkesë shtesë për sqarim përmes emailit për Sekretarin e Universitetit, Esat Kelmendi, me datë 29 janar 2020.
45 Shih shtojcën nr.1 për detaje të procesit të përzgjedhjes së Stafit akademik.
46 Neni 13, paragrafi 3 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
47 Neni 14, paragrafi 3 Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
48 Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës, Esat Kelmendi, 17 janar 2020.
49 Kërkesë shtesë për sqarim përmes emailit për Sekretarin e Universitetit, Esat Kelmendi, me datë 29 janar 2020.

Dy kandidatë i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, njëri me kërkesën që ky institucion të veprojë kundër diskriminimit në procedurën për emërim, riemërim dhe avancim, kurse tjetri lidhur me Konkursin për përzgjedhjen e personelit akademik Nr. 1/173, të datës 27 prill 2018, të Universitetit të Prishtinës.[50] Konkursi në fjalë përcaktonte se kandidatët me studime të mbaruara jashtë vendit duhet të bashkëngjesin vendimin mbi nostrifikimin e diplomës (Bachelor, Master, doktoraturë) dhe se nuk do të merret në konsideratë vetëm dëshmia e aplikimit për nostrifikim. Sipas po këtij konkursi, kandidatët e doktoruar në Universitetin e Prishtinës mund të aplikojnë me çertifikatën origjinale të diplomimit në doktoratë.

Lidhur me këtë rast, Institucioni i Avokatit të Popullit ka nxjerrë një Opinion, në të cilin përcakton se kriteri që kandidatët të sjellin vendimin e nostrifikimit të diplomës, sipas Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi është kriter diskriminues që cenon parimin e barazisë për kandidatët e diplomuar jashtë vendit.[51] Sipas këtij Opinioni, diskriminimi qëndron në faktin se kandidatëve u ndalohet pjesëmarrja në konkurs, pasi nuk arrijnë t'i nostrifikojnë diplomat para mbylljes së konkursit.[52] IAP ka vlerësuar se kërkesa që në fazën e aplikimit të dorëzohet dëshmia për njohjen e studimeve jashtë vendit nuk gjen bazë në dokumentet që rregullojnë procedurat për përzgjedhjen e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës, e se kjo kërkesë shërben si kusht për themelimin e marrëdhënies së punës dhe jo për aplikimin në konkurs.[53] IAP i ka rekomanduar Universitetit të Prishtinës t'ua mundësojë të gjithë kandidatëve që t'u nënshtrohen procedurave pa pengesa, të heqë kriterin e nostrifikimit të diplomave në Konkursin Nr. 1/173 të datës 27 prill 2018 dhe të mos e vendos si kriter as në konkurset e ardhshme.[54]

c) Parregullsitë e raportuara në lidhje me ankesat

Parregullsitë ligjore në lidhje me shqyrtimin e ankesave dhe vendimarrjen e organeve të Universitetit të Prishtinës përmblidhen si në vijim:

- Mosrespektimi i formatit të përcaktuar me ligj për nxjerrjen e vendimeve;
- Komunikimi jozyrtar dhe mosdhënia e përgjigjes me shkrim palëve që kanë parashtruar ankesa.

3.1 Mosrespektimi i formatit të vendimeve, të përcaktuar me ligj

Shumica e palëve ankuese kanë raportuar parregullsi në vendimet mbi ankesat e tyre. Nga analizimi i vendimeve në dispozicion, evidentuam se shumica nuk i përmbanin elementet e detyrueshme të vendimeve të komisioneve ankimore si organe administrative. Kjo problematikë është shprehur sidomos në mungesën e arsyetimeve sipas rregullave në fuqi.

Pas shqyrtimit të raporteve të komisioneve të ankesave, Këshilli i Fakultetit e ka për obligim t'i njoftojë me shkrim kandidatët që kanë paraqitur ankesë.[55] Arsyetimi duhet të përmbajë paraqitje të shkurtër ndaj ankesës së palës, shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi,

50 Konkursi me Nr. Protokolli 1/173 i shpallur me datë 27.04.2018 nga Universiteti i Prishtinës «Hasan Prishtina».
51 Opinion i Avokatit të Popullit në lidhje me kriterin për dorëzimin e vendimit të nostrifikimit, për aplikim, në konkursin e personelit akademik në Fakultetet e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Nr. 1810/2018, Institucioni i Avokatit të Popullit, 23 gusht 2018.
52 Po aty, faqe 11, paragrafi 3.
53 Po aty, faqe 8, paragrafi 29.
54 Po aty, faqe 11, paragrafi 4 dhe 5.
55 Neni 12, paragrafi 9, Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.

shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, si dhe shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjë nga pretendimet e palëve.[56] Arsyetimi i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës, ose i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.[57] Ndërsa mungesa e arsyetimit, ose e ndonjërit prej elementeve të tjera të detyrueshme të aktit administrativ shpie në paligjshmërinë e atij akti administrativ.[58]

Vendimet e nxjerra nga ana e organeve kompetente të Universitetit të Prishtinës gjatë procesit të përzgjedhjes së stafit akademik në Universitet në shumë raste nuk e kanë pasur bazën ligjore të qartë, apo kanë dhënë arsyetime të mangëta, të paqarta e të pamjaftueshme dhe nuk i kanë adresuar pretendimet ankimore të palëve. Rrjedhimisht, një numër i madh i vendimeve të komisioneve vlerësuese si dhe të komisioneve të ankesave janë nxjerrë në kundërshtim me kushtet procedurale të nxjerrjes së vendimeve të tilla sepse nuk i kanë përmbajtur elementet e detyrueshme të një akti administrativ.[59]

3.2 Komunikimi jozyrtar dhe mosdhënia e përgjigjes me shkrim palëve që kanë parashtruar ankesa

Në procesin e përzgjedhjes së stafit akademik, Këshilli i Fakultetit i shqyrton raportet e komisioneve vlerësuese dhe është i obliguar që lidhur me ankesat e kandidatëve të japë **përgjigje me shkrim**.[60] Shumica e kandidatëve që kanë parashtruar ankesë kanë raportuar se janë njoftuar jozyrtarisht nga kolegët ose stafi në universitet lidhur me vendimin për ankesat e tyre. Kandidatët që kanë parashtruar ankesa, kanë raportuar se janë ballafaquar me njërën nga situatat në vijim:

- Janë informuar përmes telefonit, gojarisht ose nga takimi jozyrtar me kolegë për vendimin;
- Nuk kanë marrë asnjëherë vendim dhe prandaj nuk kanë mundur t'i ndjekin hapat e mëtejmë proceduralë;
- Janë detyruar ta kërkojnë vetë nga zyrtarët e universitetit vendimin e Këshillit të Fakultetit, e në disa raste edhe vendimet e Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtresa.

Sa i përket ankesave pranë komisioneve të ankesave në fakultetet përkatëse, **15 kandidatë** kanë raportuar se vendimet është dashur t'i kërkojnë vetë. Prej tyre, 3 kanë bërë kërkesa përmes e-mailit që t'u dërgohen vendimet lidhur me ankesat e tyre. Dy kandidatë nuk i kanë marrë kurrë vendimet lidhur me ankesat e dorëzuara në fakultete.

Përmes kërkesave për qasje në dokumente publike kemi kërkuar që fakultetet të na njoftojnë se në çfarë mënyre i njoftojnë kandidatët për vendimet e marra nga Këshillet e Fakulteteve për ankesat e parashtruara dhe a i kanë njoftuar brenda afatit të përcaktuar për ankesat e parashtruara. Të gjitha fakultetet[61], me përjashtim të Fakultetit Juridik, janë përgjigjur se i kanë njoftuar palët në lidhje me vendimin e marrë nga Këshilli i Fakultetit për ankesat e tyre, brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.[62] Ndërkaq, Dekani i Fakultetit Juridik është përgjigjur:

56 Neni 48, paragrafi 1, Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
57 Neni 48, paragrafi 2, Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
58 Neni 52, paragrafi 1, nënparagrafi 4, Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
59 Neni 47, 48 dhe 52 Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
60 Neni 12, paragrafi 8 dhe 9, Rregullorja për Përzgjedhjen e Stafit Akademik.
61 Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore, Fakulteti i Edukimit, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Ndërtimtarisë, Fakulteti Filologjik. Fakulteti i Arkitekturës është përgjigjur se është pavarësuar nga Fakulteti i Ndërtimtarisë më datë 01.10.2019, prandaj nuk kanë pasur rastin të merren me konkursin e vitit 2018.
62 Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Dekanes së Fakultetit të Mjekësisë, Suzana Manxhuka, 20 janar 2020; Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Dekanit të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore, Tahir Arbneshi, 20 janar 2020; Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Dekanit të Fakultetit të Ndërtimtarisë, Abdullah Zejnullahu, 20 janar 2020;

> «Gjatë konkursit të vitit 2018, ankuesit janë njoftuar me ankesa ndaj vendimit përfundimtar të Senatit. Rregullorja nuk ka paraparë njoftim të veçantë për kandidatë brenda procedurave në Fakultet, por ka pasur përgjigje me shkrim në ankesë nga Komisioni i Ankesave dhe së bashku me raportin e Komisionit lënda është proceduar në Senat. Ka pasur një ankesë të veçantë ndaj Raportit të Komisionit Recensues të shpallur në Buletin. Mirëpo, pas vendimit të Senatit është njoftuar pala ankuese, respektivisht me vendimin përfundimtar.»

Në anën tjetër, Sekretari i Universitetit të Prishtinës, në përgjigjen ndaj pyetjeve se si janë njoftuar kandidatët për vendimet në lidhje me ankesat e tyre dhe a janë njoftuar brenda afatit, është përgjigjur: «Ne si Rektorat nuk kemi pasur ndonjë ankesë nga kandidatët në konkurs për ndonjë vonesë eventuale në përgjigje të ankesës nga njësitë akademike (nuk përjashtohet një mundësi e tillë të ketë ndodhur, por ne po flasim për atë që është paraqitur përmes ankesave në rektorat)».[63]

Lidhur me ankesat në nivel të Universitetit, përkatësisht të Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtresa, 3 kandidatë kanë deklaruar se është dashur ta kërkojnë vetë vendimin, duke shkuar më shumë se tri herë në Rektorat. 7 kandidatë kanë raportuar se nuk kanë marrë vendime me shkrim lidhur me ankesat e paraqitura pranë Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtresa por, disa prej tyre i kanë marrë informatat mbi vendimin në forma të tjera (2 e kanë dëgjuar vendimin nga mbledhja e Senatit e shfaqur online, 1 e ka gjetur vendimin në webfaqe dhe 1 e ka gjetur vendimin në dosjen e Inspektoratit të Punës). Sidoqoftë, dy prej tyre ende nuk janë në dijeni për vendimin përfundimtar në lidhje me ankesat e deponuara.

Një kandidat që ka ngritur rast në Këshillin e Etikës, ka raportuar se asnjëherë nuk është njoftuar për vendimin për raportimin e paraqitur.

Sa i përket mënyrës së kumtimit të vendimeve për ankesat e kandidatëve, fakultetet kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Disa janë përgjigjur se i dërgojnë përmes emailit, disa se ua komunikojnë vendimet kandidatëve përmes telefonit, disa kanë thënë se vendimet janë të qasshme për kandidatët në fakultet e disa vetëm kanë deklaruar se kandidatët janë njoftuar me kohë për vendimet për ankesat e tyre dhe nuk kanë treguar se si i njoftojnë palët për vendimet.[64]

Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Dekanit të Fakultetit të Arkitekturës, Fevzi Berisha, 20 janar 2020; Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Dekanit të Fakultetit Juridik, Haxhi Gashi, 20 janar 2020; Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Dekanit të Fakultetit Ekonomik, But Dedaj, 20 janar 2020; Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Dekanit të Fakultetit të Edukimit, Ethem Çeku, 20 janar 2020; Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Dekanes së Fakultetit Filologjik, Lindita Sejdiu-Rugova, 20 janar 2020; dhe Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike drejtuar Dekanit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Skender Kaçiu, 20 janar 2020.

63 Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës, Esat Kelmendi, 17 janar 2020

64 Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekanja e Fakultetit të Mjekësisë, Suzana Manxhuka, 30 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Sekretari i Fakultetit të Mjekësisë, Visar Muçaj, 31 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Sekretari i Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore, Jeton Hyseni, 23 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit të Ndërtimtarisë, Abdullah Zejnullahu, 22 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit të Arkitekturës, Fevzi Berisha, 22 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit Juridik, Haxhi Gashi, 27 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit Ekonomik, But Dedaj, 24 janar 2020; Përgjigjet në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Sekretari i Fakultetit të Edukimit, Milaim Mazreku, 29 janar 2020 dhe 30 janar 2020; Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekanja e Fakultetit Filologjik, Lindita Sejdiu-Rugova, 24 janar 2020; dhe Përgjigje në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike, Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Skender Kaçiu, 31 janar 2020.

III. Përfundime

Procesi i vlerësimit - Buletinet

- Janë evidentuar **10 raste** në të cilat raportet vlerësuese me rekomandim për përzgjedhjen e kandidatit më të mirë si staf akademik kanë qenë jo të plotë, të paqartë, ose nuk kanë përmbajtur fare arsyetimin e rekomandimit të dhënë nga komisionet vlerësuese.

- Gjithsej **9 raste** janë evidentuar në të cilat në raportet vlerësuese janë paraqitur të dhëna të ndryshme në lidhje me përvojën e punës së kandidatëve nga ato që kanë dorëzuar ata me rastin e konkurrimit. Në disa raste, sipas kandidatëve, nuk u është llogaritur fare përvoja e mëparshme e punës në mësimdhënie ose u është llogaritur vetëm pjesërisht.

- Ngjashëm, **21 kandidatë** kanë raportuar se u janë ndryshuar ose nuk u janë paraqitur fare të dhënat që kanë dorëzuar gjatë konkurrimit. Nga këta, janë evidentuar **10 raste** në të cilat një apo më shumë nga punimet shkencore të kandidatëve mungonin në raportet vlerësuese. Nga raportimet, **3 kandidatë** kanë pretenduar se nuk figuronin askund të dhënat për publikime në revista shkencore me impakt faktorë; **4 kandidatë** kanë raportuar se nuk u janë paraqitur të dhënat për nivelin e shkollimit (Master, PhD ose kandidat për PhD); **3 kandidatë** kanë raportuar se nuk i është paraqitur fare monografia e publikuar ose i janë ndryshuar të dhënat për monografinë.

- Në **2 raste**, kandidatët kanë raportuar se kundërkandidatëve në raportin vlerësues u është llogaritur punimi shkencor i papublikuar në momentin e konkurrimit.

- Në **1 raport vlerësues**, sipas kandidatëve, jo të gjithë anëtarët e komisionit e kanë nënshkruar raportin.

- Nga Fakulteti Juridik është paraqitur një raportim për parregullsi për shkak të mospublikimit të buletinit brenda afatit dhe anulimit të konkursit. Dekani i Fakultetit Juridik ka deklaruar se komisioni vlerësues është bërë jofunksional për shkak të dorëheqjes së anëtarëve të emëruar dhe kalimit të «të gjitha afateve». Sidoqoftë, para dorëzimit të kërkesës për anulim të konkursit, Fakulteti Juridik nuk e ka shfrytëzuar mundësinë që e ofron rregullorja për emërimin e profesorëve nga universitete të tjera vendore ose të jashtme. Po ashtu, në këtë rast nuk kanë kaluar «të gjitha afatet». Ka kaluar vetëm afati për nxjerrjen e raporteve vlerësuese, por jo edhe afati i përgjithshëm i përfundimit të konkursit, që e shkakton anulimin e konkursit dhe rishpalljen e pozitës në konkursin e radhës. Prandaj, kërkesa për anulimin e konkursit nga Fakulteti Juridik 32 ditë pas shpalljes, me arsyetimin se kanë kaluar «të gjitha afatet» nuk është argument i qëndrueshëm juridik dhe bie ndesh me parimin e efikasitetit të zhvillimit të procedurës administrative.

Përbërja e komisioneve

- Gjithsej **5 kandidatë** kanë parashtruar ankesa me pretendime për konflikt interesi mes kundërkandidatëve dhe anëtarëve të komisioneve vlerësuese. Asnjëri vendim për këto ankesa nuk i adreson pretendimet për konflikt të interesit.

- Sa u përket ankesave të kandidatëve për pjesëmarrjen në komisione vlerësuese të anëtarëve që nuk kanë qenë të fushës për të cilën është hapur pozita, janë evidentuar **3 raste** në të cilat raportet/vendimet për ankesa nuk i kanë adresuar këto pretendime.

- Në konkursin e vitit 2018 janë raportuar gjithsej **8 raste** ndaj anëtarëve të komisioneve vlerësuese para Këshillit të Etikës të Universitetit të Prishtinës. Të gjitha rastet «kanë përfunduar me vendime të Këshillit të Etikës duke konstatuar se nuk ka rast sipas Kodit të Etikës».

- Nuk ka pasur **asnjë rast** të dhënies së përgjegjësisë prej anëtarëve të komisioneve vlerësuese për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportet e vlerësimit ose për rekomandimet e kandidatëve.

Kontestimi i vendimeve

- Gjithsej **21 kandidatë** kanë dorëzuar **25 ankesa** zyrtare në komisionet për ankesa brenda fakulteteve për adresimin e parregullsive në vlerësimin e tyre. Prej këtyre, 15 kandidatëve u është refuzuar ankesa si e pabazuar, 2 nuk kanë marrë asnjëherë përgjigje në lidhje me ankesën nga universiteti, një kandidat ka raportuar se i është vlerësuar si e bazuar ankesa, kurse 3 kanë refuzuar të na njoftojnë lidhur me epilogun e ankesave të tyre, duke u shprehur të zhgënjyer me procesin e konkurrimit brenda universitetit.

- Gjithsej në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtresa janë paraqitur **64 ankesa**. Në ORCA janë paraqitur **16 kandidatë** që kanë raportuar për ankesat e tyre para këtij komisioni. Prej tyre, 11 kanë marrë përgjigje negative, 3 kanë marrë përgjigje pozitive, 1 nuk ka ofruar informata mbi vendimin për ankesën e tij, ndërsa 1 nuk e di epilogun në lidhje me ankesën e tij.

- Në Gjykatën Themelore të Prishtinës janë deponuar **4 padi** kundër vendimeve të Universitetit të Prishtinës për përzgjedhjen e stafit akademik. Një kandidat ka vendosur ta tërheqë padinë nga gjykata pasi e ka konsideruar humbje kohe e resursesh, ndërkaq 3 padi ende e presin procedimin në gjykatë.

- Shumica e kandidatëve që kanë parashtruar ankesë, kanë raportuar se janë informuar jozyrtarisht nga kolegët ose stafi në universitet lidhur me vendimin për ankesat e tyre. Prandaj u është dashur të shkojnë në universitet për ta kërkuar vendimin me shkrim për ankesat e tyre.

- Shumica e vendimeve për ankesa nuk i kanë përmbajtur elementet ligjërisht të detyrueshme, sidomos ato që do t'i adresonin ankesat e palëve.

- Shumica e kandidatëve që kanë parashtruar ankesa ndaj raporteve vlerësuese, kanë raportuar se janë njoftuar jozyrtarisht nga kolegët ose stafi në universitet lidhur me vendimin/raportin për ankesat e parashtruara. Fakultetet zbatojnë praktika të ndryshme për kumtimin e vendimeve për ankesat ndaj raporteve vlerësuese të kandidatëve. Disa i njoftojnë përmes emailit, disa përmes telefonit, e disa presin që palët të vijnë t'i marrin vetë vendimet në fakultet. Fakulteti Juridik nuk i njofton kandidatët për vendimet e Këshillit të Fakultetit mbi ankesat e parashtruara ndaj raporteve vlerësuese.

IV. Rekomandime

1. Senati i Universitetit të Prishtinës ta ndryshojë Rregulloren për Përzgjedhjen e Stafit Akademik dhe të përfshijë udhëzime të posaçme për anëtarët e komisioneve vlerësuese dhe të komisioneve ankimore mbi përpilimin e raporteve/vendimeve. Theks i veçantë në këto udhëzime t'i kushtohet krijimit të një formati të njësuar të raporteve vlerësuese dhe të raporteve për ankesat, me shablone që duhet të përmbajnë:

    - paraqitjen e saktë të të dhënave të kandidatëve në raportet e vlerësimit,
    - arsyetim të sqaruar për mosparaqitjen ose paraqitjen e pjesshme të ndonjë të dhëne nga dokumentacioni i dorëzuar prej kandidatit gjatë konkurrimit, dhe
    - elementet e detyrueshme në arsyetimin e secilit vendim, qoftë ky pozitiv ose negativ për kandidatin.

2. Senati i Universitetit të Prishtinës ta ndryshojë Rregulloren për Përzgjedhjen e Stafit Akademik dhe të përcaktojë qartë se paraqitja e ndryshuar ose e mangët e të dhënave të kandidatëve pa arsyetim paraqet shkelje etike dhe disiplinore nga anëtarët e komisioneve vlerësuese. Të përcaktohet shprehimisht se të gjitha denoncimet për shkelje etike gjatë procesit të përzgjedhjes akademike trajtohen nga Këshilli i Etikës.

3. Këshillat e Fakulteteve të kujdesen që secili raport vlerësues ose raport në lidhje me ankesat e palëve të lëshohet me arsyetimin që përmban të gjitha elementet e detyrueshme të një akti administrativ:

    - paraqitje të shkurtër të kërkesës/ankesës së palës,
    - shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi,
    - kriteret vendimtare për vlerësimin e dokumenteve/dëshmive,
    - bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, dhe
    - shkaqet për mospranimin e ndonjë të dhëne/pretendimi të palëve.

4. Senati i Universitetit të Prishtinës ta ndryshojë Rregulloren për Përzgjedhjen e Stafit Akadmik dhe t'i obligojë të gjitha Këshillet e Fakulteteve t'ua kumtojnë kandidatëve ankues vendimet për ankesat e tyre me shkrim përmes emailit.

5. Senati i Universitetit të Prishtinës ta ndryshojë Rregulloren për Përzgjedhjen e Stafit Akadmik dhe të sqarojë se nuk mund të njihen punimet e papublikuara në raportet vlerësuese.

6. Këshillat e Fakulteteve të përkujdesen që çdo vendim/raport për ankesa t'u dorëzohet palëve me shkrim përmes emailit dhe brenda afatit të caktuar në rregulloren e zbatueshme.

7. Këshillat e Fakulteteve të sigurohen, para dorëzimit të raporteve vlerësuese, që të gjithë anëtarët e komisionit t'i kenë nënshkruar.

8. Këshillat e Fakulteteve, Dekanët, Zyra për Çështje Akademike dhe Prorektori për Mësim të kujdesen që buletinet të dorëzohen dhe të publikohen brenda afatit të përcaktuar në rregullore, si dhe t'i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që ofron rregullorja për ta shmangur anulimin e konkurseve.

9. Këshillat e Fakulteteve, të krijojnë politika të brendshme për trajtimin e konflikteve të interesit, si dhe politika për trajtimin e raportimeve për dyshime të konfliktit të interesit nga palët e treta si dhe ato në procedurë.

10. Këshillat e Fakulteteve të sigurohen për mospjesëmarrjen në komisione të anëtarëve që nuk janë të fushës së ngushtë për pozitën e shpallur në konkurs, siç e përcakton korniza ligjore bashkë me aktet nënligjore në fuqi.

11. Këshillat e Fakulteteve, Dekanët ose Rektori të paraqesin denoncime për shkelje disiplinore në Këshillin e Etikës të Universitetit të Prishtinës për anëtarët e komisioneve vlerësuese ose të komisioneve të ankesave që përpilojnë raporte duke shkelur detyrimet e përcaktuara mbi elementet e përmbajtjes së tyre.

Shtojcë: Procesi i përzgjedhjes së personelit akademik

Avancimi akademik është proces i rregulluar me aktet e brendshme të Universitetit që ka për qëllim t'i zgjedhë kandidatët më të mirë për emërim dhe angazhim në pozitat akademike. Në vazhdim janë paraqitur hapat kryesorë të këtij procesi, për ta lehtësuar kuptimin e parregullsive të evidentuara në këtë raport.

Procedura e Konkursit	Duhet të bëhet në mënyrë transparente, me shpalljen publike të konkursit.
Konkursi	Shpallet në uebfaqe dhe është i hapur për 15 ditë kalendarike.
Fakulteti	Është i obliguar për çdo pozitë të shpallur në konkurs të caktojë komision vlerësues.
Dekani	10 ditë pas shpalljes së konkursit thërret mbledhjen për themelimin e komisioneve vlerësuese dhe të komisioneve të ankesave.
Tërheqja nga Komisioni	Kur ka arsye, brenda 5 ditësh pas formimit të komisionit, anëtari duhet ta paraqesë tërheqjen me shkrim.
Plotësimi i Komisionit	Dekani brenda 7 ditësh thërret Këshillin, e kur aprovohet dorëheqja, kërkon plotësimin e komisionit me anëtar të ri.
Raporti i vlerësimit	Komisioni vlerësues obligohet që brenda 15 ditësh pas mbylljes së konkursit, të dorëzojë raportin për kandidatët.
Këshilli i Fakultetit	Kur komisioni vlerësues nuk i respekton afatet, Këshilli e ndryshon komisionin/ formon komison të ri.
Afati pas ndryshimit	Komisionit të ndryshuar i jepet afat 10 ditë shtesë për ta hartuar dhe dorëzuar raportin
Obligimi i Komisionit	Komisioni respekton dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit të Prishtinës, Rregulloren për Përzgjedhje dhe Emërim, kushtet e konkursit, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.
Pas hartimit të raportit vlerësues	Të tre anëtarët e komisionit e nënshkruajnë raportin vlerësues dhe e dorëzojnë në Këshillin e Fakultetit.

Pas dorëzimit të raportit vlerësues	Këshilli i Fakultetit mblidhet jo më vonë se 7 ditë pas dorëzimit të raportit, për ta shqyrtuar dhe për t'i përmbyllur punët.
Pas mbledhjes së Këshillit të Fakultetit	Pasi konstaton gjendjen e raporteve vlerësuese, Këshilli i Fakultetit brenda 3 ditësh i përcjell ato në versionin elektronik te Zyra për Çështje Akademike e Universitetit.
Zyra për Çështje Akademike	Obligohet që brenda 7 ditësh të hartojë buletinet dhe t'i publikojë në uebfaqe.
Buletinet	Qëndrojnë të publikuara në kohëzgjatje prej 15 ditësh nga dita e publikimit.
E drejta për ankesë	Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese te Këshilli i Fakultetit, gjatë fazës së publikimit të raporteve.
Marrja e vendimeve për ankesat e kandidatëve	Këshilli i Fakultetit pas kalimit të afateve të buletineve, brenda 10 ditësh vlerëson raportet, vendos për miratim ose jo të tyre dhe shqyrton edhe ankesat e kandidatëve, dhe ndaj ankesave jep përgjigje me shkrim.
Pasi shqyrtohen ankesat	Këshilli i Fakultetit, pasi shqyrton raportet vlerësuese, ankesat, vendimin përkatës dhe detajet e tjera, brenda 3 ditëve i dorëzon ato te Zyra për Çështje Akademike.
Propozimet e Këshillit të Fakultetit	Dërgohen në Zyrën për Zhvillim Akademik, e cila 30 ditë pas pranimit të tyre, përgatit pasqyrat me propozimet.
Vendimi i Senatit për përzgjedhjen e personelit akademik	Merret 20 ditë pas përgatitjes së pasqyrave të propozimeve nga Zyra për Zhvillim Akademik.
Kur Senati refuzon propozimin	Lënda përkatëse brenda 3 ditëve kthehet në Këshillin e Fakultetit për rishqyrtim.
Rishqyrtimi në Këshill	Brenda 7 ditëve pasi pranon vendimin e Senatit, obligohet të rishqyrtojë lëndët, ndërsa vendimin e vet t'ia dorëzojë Zyrës për Çështje Akademike brenda 3 ditësh.
Vendimi përfundimtar i Senatit	Senati brenda afatit 20 ditë nga pranimi i propozimit të Këshillit të Fakultetit, merr vendim përfundimtar.
Ankesa ndaj vendimit të Senatit	Kandidatët e pakënaqur mund të ushtrojnë ankesë ndaj Vendimit të Senatit brenda 15 ditëve në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtresa, që është instanca e fundit në Universitet për shqyrtimin e ankesave.

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky raport është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Integriteti Akademik Përmes Aktivizmit Studentor i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.